

ALBANOLOGJIA SOT: SHTHURRJA E PARADIGMËS MBI VULLNETARIZMIN SHKENCOR

Shaban SINANI

Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë

Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

SHQIPËRI

E-mail: shsinani2000@yahoo.fr

PËRMBLEDHJE

Prej fundit të viteve 1990 paradigma tradicionale e albanologjisë është shthurur. Tezat e vazhdimësisë historike iliro-shqiptare, të autoktonisë në hapësirën e sotme, të njëjtësisë së identitetit dhe gjuhës, janë tronditur. Refuzimi metodologjik i bazave të albanologjisë së mëparshme; humbja e peshës së dijeve albanologjike të kryeqytetit të Shqipërisë si kryeqendra e mendimit shkencor shqiptar; krijimi i realiteteve të reja gjeopolitike shqiptare e rajonale; keqpërdorimi i reformës, i lirisë akademike dhe i decentralizimit institucional; romantizmi shkencor dhe “shkenca patriotike”; humbja e lidhjeve ndërmjet brezave të dijetarëve; pretendimi për t’i zgjidhur problemet jo prej argumentit të suksesshëm, por prej metodës së suksesshme; fryma e përgjithshme e çmistifikimit krahas me ringjalljen e një vargu prirjesh të vjetra rimistifikuese; kryqëzimi i nacionalizmave të vjetër dhe të rinj me shumëfarë konformizmash globalistë; refuzimi “ex principio” i arritjeve të dikurshme shpallja me “parti pris” i epërsisë së dhe teorive të reja, e kanë lënë albanologjinë e sotme në gjendje udhëkryqi, pa paradigmen e vjetër dhe pa paradigmen të re; duke e rrezikuar funksionin e saj si shkencë kombëtare dhe duke e shndërruar në një prej rrjedhave të zakonshme të albanologjisë që janë zhvilluar e zhvillohen në botën

e sotme. Rikthimi i autoritetit të albanologjisë përmes rishqyrtimit kritik të paradigme tradicionale dhe mbrojtjes së çdo paradigme të re nga amatorizmi, diletantizmi dhe sharlatanizmi, janë çelësa të një lëvizjeje të re mendimi shqiptar në dijet kombëtare.

Fjalët kyçe: *Albanologjia, paradigma tradicionale, realitete të reja gjeopolitike, decentralizimi institucional, romantizmi, amatorizmi dhe diletantizmi shkencor, nevoja e një paradigme të re.*

Key words: *Albanology, traditionalist paradigm, new geopolitical realities, institutional decentralization, Romanticism, scientific amateurism and diletantism, the necessity for a new paradigm.*

I.

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX dijet albanologjike patën arritur disa suksese të qendrueshme dhe ndërkombëtarisht të njohura. Për herë të parë kërkimet në këtë fushë morën karakterin e një shkolle, që kishte institucionet, disiplinat, metodologjinë dhe paradigmen e vet. Duke u mbështetur e duke trashëguar arritjet më serioze të studimeve shqiptare në Europë, albanologjia u bë për herë të parë një shkencë me kryeqendër vendin që *ab initio* i takonte: Shqipërinë.

Ashtu sikurse pritej, me ndryshimet që ndodhën në vend dhe në botë në dy dekadat e fundme

të shekullit të kaluar, albanologjia tradicionale pësoi një tronditje të madhe. Kohë kthesash të befashme dhe pragmatizmash po aq, periudha prej fundit të viteve 1990 e këndeje e ktheu albanologjinë nga përparësi e zotim strategjik të autoriteteve publike dhe shkencore të vendit, në një dije si gjithë të tjerat. Një reformë administrative e stërzgatur dhe pa pikësnyime të identifikuar qartë në rrjetin e trashëguar të institucioneve kërkimore, përveç që mpiu gjendjen e studimeve, konkludoi në çinteprime dhe riinteprime jo gjithnjë të vërtetuara si shkencërisht të dobishme. Në fakt, albanologjia e kohëve të reja shkoi në drejtimin e një shkence si të gjitha albanologjitë e tjera, ballkanike, europiane.

Në kushtet e një shoqërie të hapur, edhe sjellja metodologjike ndaj objektit të albanologjisë do të pësonte ndryshime. Forcimi i vetëdijes kritike ishte një prej atyre ndryshimeve pozitive që duhej ta shëndoshte gjendjen e pikës së re të nisjes. Por më të shumta qenë ndryshimet përkeqësuese. Keqkuptimi e shpërdorimi i lirisë, duke përfshirë lirinë krijuese dhe atë akademike, pruri dhe në albanologji një vullnetarizëm shkencor gjithnjë e më agresiv. Ndërkaq, vetëndryshimi i ngadaltë i mendësisë së kërkimit brenda institucioneve akademike dhe universitare favorizoi një klimë refuzimi ex principio të çdo të mire të një kohe të mëparshme. Shumë faktorë, më shumë të kontekstit historik-shoqëror se të vetë dijës, bënë që arritjet e albanologjisë së dikurshme të errësohen, që përgjegjësia e kërkimeve të reja të zbehët, që autoriteti i studimeve shqiptare në vendin e vet krahasimisht me qendrat e tjera të albanologjisë të lëkundet fort, që vetë kjo e fundit të humbë funksionin dhe atributin e saj si shkollë më vete konkurruese dhe të çnyjësohet deri në atë shkallë, sa të dalë e nevojshme të shqiptohet si kërkesë zyrtare e platformës funksionimit të rrjetit të ri të reformuar të institucioneve përparësi e kërkimeve ndërdisiplinare transversale.

II.

Albanologjia e gjysmës së dytë të shekullit XX mbi të gjitha kishte arritur jo vetëm të pohonte, por edhe të zhvillonte e të zgjidhte një paradigmë shkencore të rreptë, e cila, me gjithë kufizimet e

veta, u siguronte dijeve shqiptare konvergencë e vijimësi, seriozitet e rreptësi. Kjo paradigmë buronte prej zotimit rigoroz të energjive kërkimore në funksion të gjetjes së përgjigjeve shkencërisht të provueshme për pyetjet më thelbësore të historisë së popullit shqiptar, të gjuhës dhe kulturës së tij, të identitetit kombëtar e të vlerave të qytetërimit të tij.

A janë shqiptarët dhe paraardhësit e tyre një popull autokton në trojet e veta apo, përkundrazi, janë aloktonë, të ardhur nga dikah e të përkundur në djepe prehistorikë të tjerësh? A është prania e shqiptarëve në këtë anë të Adriatikut e vijueshme, e pandërprerë, prej lashtësisë antike deri në kohët moderne, apo, në të kundërtën, "heshtja e burimeve" prej shekullit të III deri në shekullin e XI është shprehje e zhdukjes së përkohshme të paraardhësve të tyre nga historia dhe kohë e instalimit dhe inkorporimit të ndonjë faktori etnik të ndërmjetmë? A janë shqiptarët dhe paraardhësit e tyre një bashkësi që historikisht i janë nënshtruar restriksionit, rrudhjes, apo, përkundrazi, ata kanë pasur një kulturë ekspansive, me anë të së cilës, pikërisht për këtë shkak, mund të shpjegohen, si me një çelës magjik, enigmat e misteret e gjuhëve dhe qytetërimeve gjithfarëshe, të afërta e të largëta, të gjalla e të vdekura, sinkronikisht e diakronikisht, duke mos përjashtuar lashtësinë helene e latine, madje dhe atë sanskrite e hebraike? A janë shqiptarët një popull ndenjësar (*sedens*) apo, në të kundërtën, historia e tyre është histori e një populli që ka shtegtuar nga një anë e botës në tjetrën, shpesh herë i favorizuar edhe nga pushtetet perandorakë? A janë shqiptarët një popull me qytetërim të dëshmuar në kulturën materiale, apo e shkuara e lashtë e tyre është e dëshmuar aq sa mund të jetë lashtësia e një populli baritor? A janë shqiptarët dhe gjuha e tyre vijim gjenetik dhe kulturor i ilirëve dhe ilirishtes, apo, në të kundërtën, në burimin e tyre duhen kërkuar e gjendur disa shtrate alternative, të pranishëm të gjithë njëherësh ose me ndonjë ndërthurje të pjesshme (trake, trakonilire, dako-ilire, dako-myze, pellazge, etruske)? A janë ilirishtja dhe shqipja gjuhë me lidhje të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën dhe me trungun indo-europian, pa marrëdhënie birësie a motërie me gjuhë të tjera, apo, në të kundërtën, vetë shqi-

pja është mëmë e disa gjuhëve ose është ngritur mbi nënshtrate, anështrate e mbishtrate gjuhësore të burimeve të ndryshme? A kanë shqiptarët një identitet të vetëm kombëtar, një qytetërim dhe një kulturë homogjene, apo aksidentet që historia u ka shkaktuar atyre kanë qenë aq të mëdha, sa që njëjtësia dhe homogeniteti të mbeten thjesht një pretendim i studiuesve? A ka një vetëdije kombëtare shqiptare që qendron mbi faktorët e tjerë etnokulturorë, duke përfshirë besimin, apo kjo vetëdije është një palimpsest ndikimesh prej kohërash dhe fuqish të njohura? A ka qenë kultura shqiptare një kulturë e hapur, që ka pranuar ndikime për shkak të kontaktit historik e hapësinor, pa u kthyer në një mozaik fragmentesh të huajtura andej-këndej, apo, në të kundërtën, pikërisht kultura shqiptare është ajo që ka ndikuar dhe ka lënë gjuhën e vet shpjeguese tek këto të fundit? A janë gegërishtja dhe toskërishtja dy dialekte fare të afërta të së njëjtës gjuhë, apo, në të kundërtën, dikur ka ekzistuar një “dardanishte hipotetike” si burim i pavarur historik-gjuhësor i gegërishtes? A kanë gjuha dhe kultura shqiptare një origjinalitet etnoveçues, apo pesha e ndikimeve dhe prania e huazimeve e kanë kthyer atë në një hije jehonash e rikrijimesh të vlerave të të tjerëve?

Këtyre pyetjeve thelbësore, që kanë të bëjnë me prejardhjen e një populli, me mitin e origjinës, me tipologjinë e gjuhës dhe të identitetit të tij, albanologjia tradicionale u kishte ofruar një paradigmë të sistemuar, që mbështetej në zhvillimet më objektive të dijeve shqiptare në botë, në radhë të parë në zhvillimet e albanologjisë austro-gjermane, por edhe të shkollave të tjera. Kjo paradigmë sot është shthurur e madje mund të thuhet është braktisur në heshtje. Të tjera prioritete, që kanë të bëjnë me kuptimin dhe vlerësimin e periudhave më të afërme të historisë së shtetit, popullit dhe kulturës shqiptare, kanë zënë vendin e pyetjeve themelore që duhet të përballojë një dije kombëtare. Braktisja e parimit-bazë, që çdo kërkim në dijet etnologjike dhe antropologjike që e shpërfill parimin “nga e njohura tek e panjohura”, duke nxituar drejt hipotezash që pretendojnë të shpjegojnë një të panjohur me një tjetër edhe më të panjohur, është burimi i rrjedhave të rrëmbyeshme të një “albanologjie alternative” kombëtare, që është çliruar,

sikurse thuhet me shumë hare, prej “kufizimeve internacionaliste” të dijetarëve të deritashëm shqiptarë. Në fakt ka ndodhur thjesht një ndërrim registri: albanologjia kaloi nga shqetësimet mazhoritare në ato minore.

Sthurja e paradigmes së dikurshme të albanologjisë tradicionale ka rezultuar me zhvillime dhe rrjedha nga më të pabesueshmet në këtë fushë, prej neoromantizmit, albanocentrizmit të kthyer e të kuptuar si kozmocentrizëm, shoqëruar me një fantashkencë arrogante po aq sa dhe diskredituese në kuadër të një sistemi ndërkombëtar tashmë komunikues të albanologjisë.

Për shkak të shthurjes së paradigmes, që mund të identifikohet si humbja më e madhe e albanologjisë në dy dekadat e fundme, tezat e vazhdimësisë historike iliro-shqiptare, të autoktonisë në hapësirën e sotme, të njëjtësisë së identitetit dhe gjuhës, janë tronditur, qoftë në prirjen e ngushtimit kritik të vërtetësisë së tyre, qoftë në prirjen e përjashtimit tërësor të lidhjeve mes tyre dhe të funksionalizimit të lidhjeve të reja. Sikurse është në burimin e termit, paradigma nënkupton vetëm lakueshmërinë e mundshme. Paradigma objektivisht është shumë e pushtetshme dhe rreptësisht vigjilente ndaj palakueshmërisë, që është tmerr i shkencave të rreme të mbështetura mbi vullnetarizmin. Pikërisht lakueshmëria / palakueshmëria objektive që përmbante paradigma e vjetër, e kthyer dhe përfutur si frikë prej një numri studiuesish të breznive të reja e të vjetra, është një prej shkaqeve të refuzimit të saj. Në këtë mjedis, lulëzojnë pa frenim amatorizmi, shkenca e pasionit, diletantizmi, sharlatanizmi dhe injoranca.

Flamurtarët e çmitizimit nga njëra anë, me vetëdijen megalomadhe “atdheu jam unë”; vullnetarët e “shkencës atdhetare”, të pandalshëm në vrullin e tyre, inkurajuar prej motos “Shqipëri gjithë bota”, nga ana tjetër; plus vetë strukja e kërkimit institucional, po e bëjnë albanologjinë një shkencë që mund të ndihet jetime.

III.

Refuzimi metodologjik i bazave të albanologjisë së mëparshme; humbja e peshës së dijeve albanologjike të kryeqytetit të Shqipërisë si një

kryeqendër e mendimit shkencor shqiptar; krijimi i realiteteve të reja gjeopolitike shqiptare e rajonale; keqpërdorimi i reformës, i lirisë akademike dhe i decentralizimit institucional; romantizmi shkencor dhe “shkenca patriotike”; humbja e lidhjeve ndërmjet brezave të dijetarëve; pretendimi për t’i zgjidhur problemet jo prej argumentit të suksesshëm, por prej metodës së suksesshme; fryma e përgjithshme e çmisticimit krahas me ringjalljen e një vargu prirjesh të vjetra rimistifikuese; kryqëzimi i nacionalizmave të vjetër dhe të rinj me shumëfarë konformizmash globalistë; refuzimi “en bloc” i arritjeve të dikurshme dhe shpallja me “parti pris” i epërsisë së teorive të reja, e kanë lënë albanologjinë e sotme në gjendje udhëkryqi, pa paradigme të vjetër dhe pa paradigme të re; gjë që do të thotë pa angazhim dhe përgjegjësi serioze, duke e rrezikuar funksionin e saj si shkencë kombëtare dhe duke e shndërruar në një prej rrjedhave të zakonshme të albanologjisë që janë zhvilluar e zhvillohen në botën e sotme.

Një çetë aleatësh të vetëkënaqur pellazgologësh, etruskologësh, sanskritologësh, antikologësh, tuttologësh, në emër të shndërrimit të albanologjisë në një “shkencë të vërtetë kombëtare”, në fakt e kanë kthyer albanologjinë në pikën e nisjes, duke e ekspozuar rrezikshmërisht në pamjen e vet më të dobët përballë dijes për popullin shqiptar kudo që zhvillohet; duke ia zhvleftësuar arritjet e gjysmës së dytë të shekullit XX e më në prapavajtje dhe duke shqiptuar trille kuzhine. Të fshehur pas autoritetit të disa dijetarëve që i kanë shqyrtuar me pasion lidhjet jogenetike të shqipes me gjuhë e kultura të tjera në pikëpamje të ndikimit dhe të pranisë së të dhënave; duke i interpretuar ndikimet dhe praninë si lidhje trashëgimie, ata dëmtojnë rëndë edhe vlerën modeste të arritjeve të idhujve të vet.

Rikthimi i autoritetit të albanologjisë përmes

rishqyrtimit kritik të paradigmes tradicionale dhe mbrojtjes së çdo paradigme të re nga amatorizmi, diletantizmi dhe sharlatanizmi, janë çelësa të një lëvizjeje të re mendimi shqiptar në dijet kombëtare. Në të kundërtën, një romantizëm i vonuar, krejt anakronik, që do të gjente si flamur vargjet e poetit të Rilindjes se Shqipëria ishte dhe atëherë kur:

*Adami dhe s’kishte lerë,
Në botë nuk kish të tjerë,*

rrezikon të kthejë në rrjedhë të përgjithshme të kërkimit albanologjik frymën e vet. Gjendja e midistë do të inkurajojë, sigurisht, ironinë e shprehur në dyvargëshat që njëri prej ish-kryeministrave të vendit pati perifrastuar dikur:

*Elbasan, qytet i bukur,
Në kërthizë të Shqipërisë;
Shqipëri, o vend i bukur,
Në burim të gjithësisë.*

Filozofi gjerman i shekullit XIX, L. Feuerbach shprehej se studiuesit i kthehen patriotizmit dhe e gjejnë atë si aleatin më të fuqishëm të nismave kolektive kur energjia e tyre individuale për nisma të vërteta kërkimore ka mbaruar. Në fakt, në realitetin e sotëm, ndërsa institucionet kërkimore-shkencore shtyjnë ditët e vitet nën frikën e reformës, vullnetarët e albanologjisë, duke përfituar dhe nga gjendja e pezullt dhe një paradigme tashmë “pa dalzots”, me të vetmen dhunti që mund ta gjejnë njëri-tjetrin në dritë të vetëtimës, kanë krijuar taborre që diktojnë jo vetëm refuzimin, por edhe kornizën e mendimit. Kjo gjendje të kujton një prej shembëlltyrave në letërsinë ungjillore gnostike, në të cilën Jezui i jep përgjigje pyetjes dinake të dëgjuesve të vet pse djetmë nuk po u ngajjnë më etërve të tyre: “Ata i ngajjnë kohës”.